



Leave
No One
Behind



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË



UNITED NATIONS
ALBANIA



BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT NË PROCESIN E EDUKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

2021



Udhëzues për aktivitete të përbashkëta midis mësuesit
ndihmës, mësuesit lëndor dhe prindërve të fëmijëve me
aftësi të kufizuar

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
PJESA E PARË	3
HYRJE	4
PSE DHE KUJT I SHËRBEN KY UDHËZUES?	5
KU MBËSHTETEN AKTIVITETET E SUGJERUARA?	6
REALIZIMI I AKTIVITETEVE DHE MATERIALET E PËRDORURA	7
Fëmijët që mund të realizojnë aktivitetet e paraqitura janë:	8
Këshilla për mësuesit	8
AKTIVITETE PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE NË SHKOLLË	11
Unë dhe profesioni im.....	12
Një dite vullnetar në klasë/shkollë.....	12
Luajmë dhe fitojmë bashkë.....	13
Ditë të hapura	13
Konferenca prindërore.....	13
AKTIVITETE PËR MJEDISIN	15
Vazo me lule	16
Kolazh i kopshtit tim	17
Lule me plastelinë.....	18
Një lule me shumë	19
Shkolla ime lulëzon	20
AKTIVITETE PËR RUAJTJEN E TRADITËS DHE ZAKONEVE	21
Sa kushton?.....	22
Shporta me ushqime.....	23
Karroca për pazare.....	24
Unë jam kuzhinier.....	25
Këndojmë dhe kërcëjmë këngët tona	26

Panairi i traditës tonë	27
PJESA E DYTË	28
VEPRIMTARI MËSIMORE.....	29
Lënda: Gjuhë shqipe	30
LËNDA: Matematikë.....	32
Lënda: Art pamor	35
Lënda: Gjuhë shqipe	37
Lënda: Art pamor	39
Lënda: Abetare	41
Lënda: Biologji.....	43

PJESA E PARË

HYRJE

Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes janë njerëzit më të rëndësishëm në jetën e fëmijës. Ata janë të përfshirë në procesin e të mësuarit dhe të zhvillimit të fëmijëve të tyre që kur ata lindin. Kur bëhet fjalë për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar, themi me plot bindje se ata janë një ndër faktorët kyç në zhvillimin e fëmijës. Përfshirja e familjes nuk është thjesht pjesëmarrja në veprimtari, ngjarje dhe programe që përbëjnë botën e fëmijës, por është një përfshirje aktive duke marrë role dhe përgjegjësi. Duke njohur faktin që prindërit/anëtarët e familjes dallojnë shumë nga gatishmëria, aftësia dhe koha e disponueshme për t'u përfshirë në veprimtaritë e shkollës, shkollat duhet të ofrojnë një vazhdimësi mundësish për pjesëmarrjen e tyre. Duhet të vihet në dukje që studimet (Henderson dhe Mapp 2002) kanë treguar se një nga mënyrat më efektive për të ndikuar në suksesin e fëmijëve, është lidhja e rezultateve të fëmijëve me familjen, duke përfshirë këtë të fundit në proceset e vendimmarrjes për qëllimet e procesit të të mësuarit.

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet të shihen dhe të trajtohen në shkollë si aset dhe jo si një detyrim. Një nga mënyrat më të mira për t'i parë si pasuri, është që t'i përfshihet ata në një vendimmarrje të përbashkët rreth procesit të të mësuarit të fëmijëve, rreth zhvillimit të tyre dhe jetës shoqërore në klasë. Përfshirja e prindërve nuk mund të sjellë rezultate të pritshme, nëse kjo përfshirje bazohet në nisma dhe veprimtari individuale të mësuesve. Ajo duhet të bazohet në një planifikim vjetor bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet. Mësuesit ndihmës, bashkë me mësuesit lëndorë, duhet që, nëpërmjet planit vjetor të aktiviteteve që shkolla ka planifikuar të zhvillojë gjatë vitit akademik, të shikojë mundësinë se si mund të përfshihen në këto veprimtari prindërit dhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Shkolla asnjëherë nuk duhet t'ia lërë rastësisë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prindërve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar në aktivitetet e shkollës. Mësuesit nuk duhet të planifikojnë aktivitetet specifikisht për prindërit dhe fëmijët me aftësi të kufizuar, por stafet pedagogjike duhet të gjejnë mënyra se si të përfshijnë prindërit dhe fëmijët me aftësi të kufizuar në aktivitetet e planifikuara.

PSE DHE KUJT I SHËRBEN KY UDHËZUES?

Shpeshherë mësuesit ndihmës gjenden përballë faktit se si të mund të përfshijnë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollë. Ndonjëherë, përballë kësaj dileme janë edhe prindërit, të cilët, për arsye të ndryshme, nuk dinë se si të bëhen pjesë aktive e shkollës.

Ky udhëzues mund t'u vijë në ndihmë stafëve pedagogjike, mësuesve ndihmës, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar që të shfrytëzojnë kohën dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë për një arsim sa më cilësor dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuar. Udhëzuesi synon të nxisë, përmes aktiviteteve të gatshme, pjesëmarrjen aktive në shkollë të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar si dhe krijimin e një bashkëpunimi ndërmjet mësuesve dhe prindërve drejt një arsimi sa me gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuar. Veprimtaritë mund të zhvillohen në aktivitetet ekstrakurrikulare që shkollat zhvillojnë, por edhe në tema të veçanta të cilat trajtohen në kurrikulën e shkollës. E rëndësishme është që prindërit të përfshihen dhe të japin kontributin e tyre në shkollë, të zhvillojnë aktivitete cilësore dhe të punojnë me fëmijën duke koordinuar punën me mësuesin ndihmës ose mësuesin lëndor.

Materiali ka në fokus fuqizimin e bashkëpunimit midis mësuesit ndihmës, mësuesve lëndorë dhe prindërve, i cili vjen si rrjedhojë e një koordinimi dhe të punuari në skuadër. Udhëzuesi është hartuar për të afruar dhe për të krijuar një bashkëpunim të frytshëm midis mësuesit lëndor, mësuesit ndihmës dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Nëpërmjet një pune të koordinuar, mësuesit së bashku me prindërit mund të zhvillojnë një sërë aktivitete gjithëpërfshirëse në dobi të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Aktivitetet e ofruara më poshtë nuk janë të vetmet. Ato janë mbështetur në praktika gjithëpërfshirëse, në aktivitete të edukimit joformal me anë të të cilave nxitet zhvillimi i aftësive intelektuale, sociale, fizike, gjuhësore dhe emocionale të fëmijët me aftësi të kufizuar.

KU MBËSHTETEN AKTIVITETET E SUGJERUARA?

Udhëzuesi është ndërtuar mbi bazën e eksperiencave të aktiviteteve të realizuara nga fëmijë me aftësi të kufizuar, prindër dhe mësues në jetën e përditshme në klasë, shkollë apo edhe gjatë pjesëmarrjes në kampet verore apo aktivitete passhkollore. Për ta bërë sa më praktik dhe konkret këtë udhëzues, sugjerimet për një pjesë të aktiviteteve janë bazuar në aktivitete pothuajse të përvitshme, rutinë që organizojnë shkollat, si aktivitete për mjedisin, aktivitete për ruajtjen e traditave dhe zakoneve, konkurse etj. Udhëzuesi orienton mësuesit ndihmës dhe prindërit që të mos e lënë në momentit e fundit pjesëmarrjen dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në këto aktivitete, por të nxisin dhe të bëjnë pjesë aktive prindërit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara në zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Është e rëndësishme të theksojmë se puna për përfshirjen e prindërve në shkollë duhet të jetë një proces në vazhdim. Ndaj, mësuesit ndihmës duhet të jenë kreativ për të mbajtur prindërit të energjizuar dhe për t'i ndihmuar ata për t'u bërë më efektivë në punën me fëmijët.

REALIZIMI I AKTIVITETEVE DHE MATERIALET E

PËRDORURA

Aktivitetet e planifikuara në udhëzues janë aktivitete të cilat mund:

- të organizohen në klasë, shkollë nga mësues, prindër dhe nxënës;
- të realizohen në shtëpi nga prindërit dhe fëmijët;
- të organizohen në shkollë – shtëpi – shkollë ose anasjelltas, shtëpi– shkollë.

Udhëzuesi përmban aktivitete të cilat kërkojnë si bazë: materiale të riciklueshme apo mjete që gjenden lehtë dhe pa kosto. Materiale të riciklueshme mund të gjejmë kudo si gjethe, lule, libra, revista dhe gazeta të vjetra, kanoçe ose shishe plastike, kopsa me ngjyra, kuti kartoni etj. Gjithashtu, aktivitete të sugjeruara, në pamundësi për të pasur bazën materiale të kërkuar, mund të përshtaten. Për zhvillimin e aktiviteteve, mësuesit dhe prindërit duhet të jenë fleksibël dhe të kenë një të kuptuar të përbashkët për qëllimin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit. Aktivitetet nuk janë vetëm për fëmijët pa aftësi të kufizuar, por mund t'i realizojnë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Pra, aktivitete janë të realizueshme nga të gjithë fëmijët, përfshirë këtu fëmijët me aftësi të kufizuar. Mësuesit, në këto aktivitete, përfshijnë gjithë nxënësit e klasës duke dhënë punë individuale në shtëpi apo punë në grupe në klasë. Pjesë e kësaj pune janë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Prindërit, kujdestarët, mësuesit mund të zgjedhin në bazë të vështirësive që ka fëmija, aktivitetin që do të zhvillojnë.

Udhëzuesi ka aktivitete të cilat nxisin zhvillimin e shkathtësive të koordinimit sy-dorë, motorikës fine dhe asaj globale, përdorimin e fjalëve dhe imazheve për të përfaqësuar botën, logjikën rreth ngjarjeve konkrete, besimin si dhe angazhimin në aktivitete autonome. Aktivitetet zhvillohen në formë loje, duke u dhënë prindërve dhe mësuesve mundësi të pafundme për ndërveprimin e fëmijëve me njerëzit dhe objektet, në situata reale dhe imagjinare. Aktivitetet janë pjesë e punës që bëhet me fëmijët me aftësi të kufizuar në kuadër të zhvillimit të tyre, për të siguruar një ecuri dhe një edukim sa më cilësor për të gjithë. Këto aktivitete mund të jenë pjesë e punës së mësuesit ndihmës, të koordinuar me mësuesin lëndor dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar duke kontribuar në arritjen e objektivave të vendosura në Planin Edukativ Individual të fëmijës.

Nëpërmjet bashkëpunimit dhe realizimit të aktiviteteve, prindërit rrisin vetëbesimin e tyre për të kontribuar në shkollë. Komunikimi dhe përfshirja e mësuesit ndihmës me prindërit, duhet të nxisë dhe të prodhojë aktivitete të cilat zhvillojnë prirjet e fëmijës me aftësi të kufizuara, por që janë pjesë përbërëse e aktiviteteve të planifikuara në klasë/shkollë, në realizimin e orëve ekstrakurrikulare dhe aktiviteteve që kontribuojnë në arritjen e objektivat të Planit Edukativ Individual.

Fëmijët që mund të realizojnë aktivitetet e paraqitura janë:

- fëmijët me autizëm;
- fëmijët me prapambetje mendore të lehtë;
- fëmijët me prapambetje mendore të mesme;
- fëmijët me SindromaDown;
- fëmijët me epilepsi- prapambetje mendore-çrregullim në sjellje;
- fëmijët me epilepsi- suspekt gjenetik;
- fëmijët me SindromaYest-Epilepsi;
- fëmijët me paralizë cerebrale;
- fëmijët me paraplegji;
- nxënësit me nevoja sjellore emocionale dhe sociale;
- multidiagnozë;
- nxënës që paraqesin çrregullime të vëmendjes dhe/ose hiperaktive.

Këshilla për mësuesit

- Komunikoni me prindërit dhe ndani me njëri tjetrin të gjitha përshtypjet nga zhvillimi i aktivitetit deri në fund të tij. Kjo do ju japë mundësi të krijoni ura të mira komunikimi dhe të keni rezultate të fëmija me aftësi të kufizuara. Bisedoni me prindërit për sukseset e arritura të fëmijës gjatë realizimit të aktivitetit. Diskutoni mësues ndihmës-mësues lëndor -prindër se cilat ishin veprimtaritë që pëlqeu me shumë fëmija? Po më të bezdisshmet? Cilat veprimtari fëmija i realizonte lehtësisht dhe cilat jo? Të gjitha këto elemente do të rrisin komunikimin e mësuesit me prindin, besimin e prindërit ndaj mësuesit dhe do të ndihmojnë mësuesit për të ndërtuar veprimtari të tjera të cilat nxisnin zhvillimin e fëmijës me aftësi të kufizuara.

- Si mësues ndihmës, nxisni bashkëveprimin e prindërve me shkollën duke shfrytëzuar çdo hapësirë të krijuar.
- Lërin prindërit të flasnin dhe dëgjojnë me vëmendje.
- Kërkoni të merrni si informacion nga prindërit se për çfarë kanë nevojë prindërit për të qenë pjesë aktive në shkollë dhe ku mund të kontribuojnë ata më mirë. Kjo do t'ju ndihmojë të përfshini prindërit në aktivitetet e planifikuara në nivel shkolle apo klase.
- Tërhiquni vëmendjen prindërve që aktivitetet të zhvillohen në mjedis sa më të sigurt dhe motivues për fëmijët dhe të zhvillohen në formën e lojës.
- Udhëzoni prindërit të përdorin fjalët motivuese për fëmijët: bravo, e bërë shumë mirë, sa bukur, më pëlqen etj. ose të vendosin një stimul për çdo aktivitet që kryen fëmija.
- Udhëzoni prindin që gjatë zhvillimit të një aktiviteti me fëmijën, të përsërisë veprimet që është duke bërë dhe njëkohësisht ta komunikojë atë si veprim. T'i flasë fëmijës në mënyrë frekvente gjatë aktiviteteve të jetës së përditshme, duke ia përshkruar ato; të punojë me figura dhe fjalë të shkruara. Këto dhe elemente të tjera, favorizojnë dëshirën e fëmijës për t'u shprehur, zhvillimin e kapaciteteve të tij dhe njohjen e sa më shumë fjalëve.
- Prindërit duhet të ruajnë qetësinë kur zhvillojnë aktivitetet me fëmijët e tyre. Ata nuk duhet të shqetësohen apo të humbin durim kur fëmija nuk u përgjigjet udhëzimeve. Duhet të merret me pozitivitet, të qetësohen pak edhe të vazhdojnë më pas.
- Sugjerojuni prindërve të kenë një orar në ditë për të zhvilluar dhe për t'iu përkushtuar aktiviteteve me fëmijën me aftësi të kufizuara, duke e kthyer këtë orar në rutinë. Nëse shikoni që fëmija nuk ka dëshirë për ta zhvilluar një aktivitet në atë moment, atëherë këshilloni prindërit të shikojnë një kohë tjetër për zhvillimin e aktivitetit. Mos e vazhdoni veprimtarinë tej caktimit të durimit apo interesit të fëmijës.
- Udhëzoni prindërit të ndjekin interesin e fëmijës në aktivitetet e zhvilluara, të mos imponohen, por të ndihmojnë fëmijën duke u komunikuar se ata po bëjnë diçka të bukur, diçka entuziaste e cila do t'u shërbejë shokëve, klasës dhe shkollës ku mëson fëmija.
- Udhëzoni prindërit të dokumentojnë aktivitetin e zhvilluar me foto, video etj. Kjo do t'ju jap mundësinë si prindërve dhe mësuesve të shikojnë dhe të evidentojnë zhvillimin e fëmijës në kohë.

Pas përfundimit të çdo veprimtarie, sugjerojuni prindërve të plotësojnë për fëmijën tabelën e emocioneve në lidhje me aktivitetin e zhvilluar.

TABELA E EMOCIONEVE



ASPAK



MJAFTUESHËM



SHUMË

AKTIVITETE PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE NË SHKOLLË

Këshillohet që, si staf pedagogjik, të planifikoni në fillim të vitit akademik përfshirjen e prindërve në shkollë. Vendosi në planin vjetor të aktiviteteve mënyrën e përfshirjes së prindërve në klasë apo në shkollë. Mos harroni dhe mos diferenconi prindërit, aq më shumë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Ndajeni nismën me prindërit e klasës në mbledhjen e parë të prindërve dhe kërkoni nga ata mbështetje për realizimin e kësaj nisme. Kërkoni nga çdo prind se si do të mund të kontribuojë një ditë në klasën e fëmijës së tyre. Më poshtë janë përmendur disa aktivitete në të cilat mund të përfshihen prindërit për një shkollë sa më gjithëpërfshirëse.

Aktivitetet e propozuara:

1. Unë dhe profesioni im
2. Një ditë vullnetar në klasë/shkollë
3. Luajmë dhe fitojmë bashkë
4. Ditë të hapura
5. Konferenca prindërore

Unë dhe profesioni im

Ftoni prindërit, të afërmit apo gjyshërit me profesione dhe eksperiencë të ndryshme që të vijnë në klasë dhe t'u tregojnë fëmijëve rreth profesionit dhe eksperiencave të tyre. Ndajeni me prindërit si aktivitetet dhe planifikoni me anë të një grafiku vjetor



ardhjen në klasë për këtë qëllim. Në varësi të profesionit, prindërit mund të sjellin ngjarje, eksperiencë: mjek/infermier - konsulta për higjienën, stilin e shëndetshëm të jetesës, masat e marra për parandalimin e sëmundjeve etj., polici - rregullat e trafikut, rregulla të përgjithshme që duhet t'i dimë dhe t'i respektojmë, një murator - ndan me fëmijët eksperiencat e tij të ndërtimit të objekteve, çfarë i pëlqen nga puna

e tij etj. ose çdo specialist mund të bëjë thjesht një prezantim të profesionit të tij në mënyrë që fëmijët të udhëzohen më mirë në zgjedhjen e ardhshme të profesioneve. Mos harroni, të gjithë prindërit kanë eksperiencë për të treguar.

Një dite vullnetar në klasë/shkollë

Një pjesë e konsiderueshme e prindërve, pavarësisht se duan të përfshihen në shkollë, nuk e dinë se si. Me qëllim nxitjen dhe përfshirjen e prindërve në shkollë, secili nga mësuesit paraqet tek prindërit në fillim të vitit akademik, një listë me aktivitete se si ata mund të përfshihen në shkollë duke e lënë si mundësi zgjedhjeje nga vetë prindërit ditën për të qenë pjesëmarrës në shkollë. Klasa/shkollat shpesh kanë nevojë për vullnetarë të cilët mund të zhvillojnë këto aktivitete:

- ndihma në klasën e fëmijës duke mbështetur mësuesen në orën e mësimit;
- vullnetar për të shërbyer në bibliotekën e shkollës;
- bërja pjesë e takimeve të bordit të shkollës apo këshillit të prindërve;
- ndihma për klasën/shkollën e fëmijës për projekte të ndryshme që duan të realizojnë;

- ndihma në organizimin e një aktiviteti argëtues për fëmijët/klasën dhe shkollën;
- ndihma në përgatitjen e bazës materiale mësimore sipas nevojës së mësuesve;
- ndihma si shoqërues në aktivitetet, ekskursionet që shkolla zhvillon.

Pasi prindërit zgjedhin aktivitetin që do të përfshihen, hartohet një kalendar për përfshirjen e prindërve sipas dëshirës që ata kanë dhënë për pjesëmarrje. Ky kalendar ndahet me prindërit për t'u zbatuar.

Luajmë dhe fitojmë bashkë

Një mënyrë tjetër se si prindërit mund të përfshihen në shkollë, është dhe organizimi i konkurseve të ndryshme. Zhvillimi i një ndeshje volejboli/basketbolli midis prindërve të klasave të ndryshme ose midis prindërve dhe mësuesve është një nga aktivitetet. Ky aktivitet do afrojë prindërit me stafin e mësuesve dhe do t'i bëjë ata më miqësorë me njëri-tjetrin. Në shkollat që është zhvilluar ky aktivitet, ka gjetur jo vetëm përfshirjen aktive të prindërve, por edhe një komunikim dhe krijim të një marrëdhënieje të mirë midis prindërve dhe mësuesve. Ky aktivitet mund të zhvillohet edhe midis prindërve dhe nxënësve apo midis prindërve dhe bordit të shkollës.

Ditë të hapura

Gjatë një viti akademik, planifikoni në planin tuaj vjetor që në 2 ditë të vitit, shkolla të jetë e hapur për gjithë komunitetin. Prindërit mund të vijnë të marrin pjesë në orët e hapura që zhvillojnë mësuesit, mund të kalojnë një ditë nga fillimi deri në fund dhe të shikojnë se si zhvillohet procesi mësimor në shkollë, mund të shuajnë çdo kuriozitet që ata kanë për shkollën. Në fund të zhvillimit të këtij aktiviteti, me anë të një pyetësi anonim, kërkoni nga prindërit të merrni opinionet e tyre për gjërat që ata kanë pëlqyer dhe çfarë do të sugjeronin të bëhej më shumë në shkollë.

Konferenca prindërore

Një nga mënyrat e suksesshme të përfshirjes së prindërve në shkollë, është edhe informimi i tyre për çështje të rëndësishme që i përkasin procesit të të mësuarit dhe

shkollës. Prindërit, jo vetëm duhet të informohen nga shkolla, por ata duhet të rrisin edhe më shumë njohuritë e tyre rreth pyetjeve që mund të kenë rreth saj. Një mënyrë shumë e mirë për përfshirjen e prindërve në shkollë është dhe organizimi i konferencave prindërore. Për vendin tonë, ky aktivitet është një eksperiencë e re, por jo e paralizueshme. Konferenca mund të organizohet në ambientet e shkollës nëpërmjet strukturës së Bordit të Shkollës, Këshillit të prindërve dhe prindërve të tjerë. Drejtoria e shkollës dhe stafi pedagogjik, mund të jenë dëgjues dhe vëzhgues në këtë konferencë. Përmbajtja e konferencës është e bazuar në eksperiencat pozitive të punës në shkollë, në elemente të kontributit të dhënë nga prindërit si dhe në sugjerime konkrete për rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjen në shkollë.

AKTIVITETE PËR MJEDISIN

Në shkollat e arsimit parauniversitar, në planin vjetor të aktiviteteve, planifikohen për t'u zhvilluar gjithmonë aktivitete për mjedisin. Për disa nxënës me aftësi të kufizuar, mbjellja e luleve është proces shumë i dashur dhe sidomos ujitja është veprimtari qetësuese. Aktivitetet e propozuara mund të zhvillohen në vijimësi me njëra-tjetrën duke arritur në aktivitetin përmbyllës final të mbjelljes së luleve apo pemëve në mjediset e shkollës. Aktivitetet e mjedisit janë një mënyrë e mirë e përfshirjes së prindërve në shkollë, ku prindërit, duke ndihmuar fëmijët e tyre, përfshihen dhe marrin pjesë aktivisht. Ata mund të nxiten nga stafi i mësuesve që të jenë udhëheqës të aktivitetit final. Aktivitetet lidhen me njëra-tjetrën dhe kontribuojnë në realizmin sa më me sukses të aktivitetit final.

Aktivitetet e propozuara:

1. Vazo me lule
2. Kolazh i kopshtit tim
3. Lule me plastelinë
4. Një lule më shumë
5. Shkolla ime lulëzon

Vazo me lule

Materialet: fletë nga revistat, gazeta apo interneti të pamjeve me lule të ndryshme, gërshërë, pipa, lëndë ngjitëse.

Veprimtaria:

- Përzgjidhen disa revista, gazeta apo pamje nga interneti me lule të ndryshme. Zgjidhni bashkë me fëmijën lulet që fëmija pëlqen më shumë.
- Prindi së bashku me fëmijën presin me konture lulet e përzgjedhura nga materiale të ndryshme.
- Në një letër të bardhë vizatojmë disa gjethe. Prindi mund të bëjë vetëm konturet dhe me pas fëmija e ngjyros.
- Pasi ka përfunduar edhe ngjyrosja, priten me gërshërë gjethet.
- Më pas ngjisim me lëndën ngjitëse lulen tek pipat.
- Marrim një shishe plastike dhe e presim me formë.
- Zbukurojmë shishen plastike sipas dëshirës për ta kthyer në një vazo.
- Më pas, vazon e krijuar e mbushim me lulet e bëra.



Vazon me lule e vendosim në klasë.

Aktivitet i koordinuar. Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi, më pas puna mund të vazhdojë në shkollë dhe finalizohet në shtëpi.

Kolazh i kopshtit tim

Materialet: lule të ndryshme, tabak kartoni, ngjyra etj.

Veprimtaria:

- Së bashku me fëmijën me AK, prindërit bëjnë disa ditë shëtitje të qëllimshme në mjedisin ku jetojnë në park, lulishte etj.
- Qëllimi i shëtitjeve është të mbledhin lule të ndryshme për të krijuar mozaikun e kopshtit që ata pëlqejnë të kenë.
- Gjatë shëtitjeve, prindërit flasin me fëmijën e tyre duke i treguar here pas here cili është qëllimi i shëtitjes, pse ata do të mbledhin lule, cilat janë lulet që fëmija pëlqen më shumë.
- Pas çdo dite shëtitjeje, prindi, së bashku me fëmijën, vendos të gjitha lulet e mbledhura faqe me faqe në një libër për t'i lënë atje disa ditë deri sa të thahen.
- Pas tharjes, lulet ngjiten në tabakun e kartonit sipas dëshirës që fëmija ka.
- Tabaku bashkë me lulet dërgohet në klasë ku ekspozohet.



Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi.

Lule me plastelinë

Materialet: plastelinë me ngjyra të ndryshme ose në pamundësi të plastelinës, brumë, letra të bardha A4 ose tabakë.



Veprimtaria:

- Merrni plastelinë me ngjyra të ndryshme.
- Krijoni me fëmijën lule me forma sa më të larmishme. Nëse keni mundësi, ju mund të bëni 3-4 kallëpe formash lulesh dhe të lehtësoni pak punën e fëmijës tuaj.
 - Nëse jeni duke punuar me brumë, atëherë lulet e krijuara, ngjyrosini me ngjyra të ndryshme duke krijuar kështu një kopsht me lule.
 - Me pas, spërkatini lulet e krijuara me deodorante të ndryshme.



Aktivitet i koordinuar. Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi, më pas puna mund të vazhdojë në shkollë dhe finalizohet në shtëpi.

Një lule me shumë

Materialet: një vazo bosh, substrat, pleh për lule, një lule, një lopatë e vogël (mund të përdoren lopatat e plazhit).

Veprimtaria:

- Merrni një vazo dhe mësoni fëmijën si ta mbushë me substrat dhe pleh.
- Gjatë kohës që fëmija është duke mbushur vazon, ju i tregoni se cili është qëllimi, pse po mbillni lule, ku do ta çoni lulen e mbjellë.
- Mundohuni të krijoni bashkë me fëmijën një dialog ku ju mund të pyesni dhe ai të përgjigjet ose kur ju të flisni, ai të përsërisë veprimet tuaja.
- Merrni së bashku me fëmijën lulen dhe vendoseni në qendër të vazos. Vazhdoni përsëri hidhni substratin dhe ngjisheni.
- Më pas, ujiteni lulen e sapo mbjellë për ta bërë gati për ta çuar në klasë.
- Ju mund të shikoni edhe në internet se si mund të mbjellim një lule dhe ia tregoni disa herë fëmijës.
- Lulen e mbjellë çojeni në klasë.



Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi dhe është një aktivitet paraprirës për aktivitetin përmbyllës.

Shkolla ime lulëzon

Materialet: pemë dhe lule të ndryshme të cilat sillen nga prindërit ose blihen me fondet e shkollës, vegla pune.

Veprimtaria:

- Ftojmë prindërit që të jenë pjesë e aktivitetit që organizon shkolla, duke dhënë dhe kontributin e tyre personal për mbjelljen, krasitjen, plehërimin e pemëve dhe luleve.
- Prindërit bashkë me fëmijët ndahen në grupe të vogla.
- Secili grup orientohet në një kënd të caktuar ku do të realizohet veprimtaria për mbjelljen e pemëve/luleve.
- Bazuar në eksperiencën që prindi ka pasur në punën individuale me fëmijën në shtëpi, merr përsipër të zhvillojë aktivitetin që fëmija e ka bërë me dëshirë p.sh. ujitjen e pemës/lules pasi është mbjellë, hedhjen e dheut në gropën që është hapur për të mbjellë lulen etj.



Sugjerohet që ky aktivitet të udhëhiqet nga prindërit.



Aktiviteti realizohet në klasë/shkollë.

AKTIVITETE PËR RUAJTJEN E TRADITËS DHE ZAKONEVE

Aktivitetet për ruajtjen e traditës së zonës si panairi i gatimeve, koncertet me veshje tradicionale dhe kërcimet e zonës, janë aktivitete në të cilat përfshihen edhe energjizohen gjithë aktorët në shkollë. Rolin kryesor në këto aktivitete e kanë prindërit. Prindërit duhet të komunikojnë me mësuesit dhe njëkohësisht të punojnë me fëmijët për të arritur realizimin sa më me sukses të këtij aktiviteti. Nga eksperiencat e mëparshme, ky aktivitet është shumë i preferuar nga të gjithë aktorët në shkollë, mësues, prindër dhe fëmijë. Sugjerohet që përpara se të arrihet në aktivitetin final, të zhvillohen disa aktivitete të cilat forcojnë bashkëpunimin me prindërit dhe njëkohësisht japin rezultate të orientuara te fëmijët me aftësi të kufizuar. Aktivitetet lidhen me njëra-tjetrën dhe kontribuojnë në realizimin sa më me sukses të aktivitetit final.

Aktivitetet e propozuara :

1. Sa kushton?
2. Shporta me ushqime
3. Karroca për pazare
4. Unë jam kuzhinier
5. Këndojmë dhe kërcëjmë këngët tona
6. Panairi i traditës sonë

Sa kushton?

Materialet: lekë të prerjeve te vogla 5 lekë, 10 lekë, 20 lekë, 50 lekë, foto të produkteve me çmime deri në 50 lekë.

Veprimtaria:

- Në kuadër të aktivitetit final, në bazë të mundësive që ka fëmija me aftësi të kufizuar, mund të fillohet të mësohet përdorimi i lekëve në shuma të vogla.
- Prindi komunikon qëllimin e aktivitetit. Ai flet me fëmijën pse duhet të mësojë të përdorë lekët, ku mund të përdoren lekët etj.
- Më pas, prindi i prezanton fëmijës lekët si dhe disa fotot të produkteve që fëmija pëlqen.
- Fillohet gradualisht duke mësuar fëmijën me lekët me prerje të vogël. Prindi përsërit disa herë fjalët dhe veprimet.



- Nëpërmjet improvizimit, i paraqet fëmijës foton e një produkti ose vetë produktin me çmimin përkatës. Sugjerohet që në fletët e produktit të jetë vendosur çmimi në mënyrë shumë të dukshme. Pra, prindi mund ta ngjisë çmimin vetë për të qenë sa më i kuptueshëm për fëmijët.
- Këtë aktivitet prindi e përsërit disa herë.
- Në mënyrë të koordinuar, ky aktivitet zhvillohet edhe në shkollë me mësuesin ndihmës, por ai kërkon një komunikim dhe koordinim shumë të mirë midis mësuesit ndihmës dhe prindit. Sugjerohet që prindi dhe mësuesi të punojnë me të njëjtat foto. Aktiviteti është i shtrirë në kohë deri sa të arrihet objektivi i vënë.


Aktivitet i koordinuar. Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi, më pas puna mund të vazhdojë në shkollë dhe finalizohet në shtëpi

Shporta me ushqime

Materialet: format A4, fruta dhe perime, një kuti ose një shportë, lekë.

Veprimtaria:

- Mësuesja ndihmëse, së bashku me prindin, kanë vizatuar në format A4 konturet e frutave dhe perimeve të ndryshme. Këto vizatime mund t'i bëjnë edhe nxënës apo bashkëmoshatar në klasë.
- Prindi merr fletë të vizatuara me fruta dhe perime të ndryshe dhe së bashku me fëmijën me aftësi të kufizuar, fillojnë dhe ngjyrosin frutat dhe perimet.
- Më pas, fletët e ngjyrosura priten sipas formës. Gjatë kohës së realizimit të aktivitetit, prindi përsërit shpeshherë emrin e frutit apo perimeve që fëmija është duke ngjyrosur ose duke prerë.
- Pasi ka përfunduar ngjyrosja dhe prerja e frutave dhe e perimeve, prindi ose mësuesja ndihmëse improvizojnë një dyqan ku blihen këto fruta-perime duke përforcuar edhe njohuritë e marra për përdorimin e lekëve.



Aktivitet i koordinuar. Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi, më pas puna mund të vazhdojë në shkollë dhe finalizohet në shtëpi.

Karroca për pazare

Materialet: çanta për pazare, karroca/koshi për mbajtjen e produkteve në dyqan, lekë.

Veprimtaria:

- Të shkosh të bësh pazaret me një fëmijë me aftësi të kufizuar, për të rriturit është një sfidë e vërtetë. Por prindërit këshillohen ta bëjnë shpesh këtë me fëmijët e tyre.
- Si në çdo aktivitet tjetër, prindi duhet t'i tregojë fëmijës qëllimin e asaj që ata do të zhvillojnë. Ai duhet të flasë me fëmijën; ku po shkojnë, çfarë duan të blejnë, për çfarë do t'u duhen produktet e blera, gjithmonë duke mbajtur në vëmendje aktivitetin final që do të zhvillohet në shkollë – “Panairin e traditës”.
- Çdo veprim që prindi bën, e artikulon me zë të lartë dhe ia tregon fëmijës.



- Produktet që do të blejnë, prindërit mund t'i kenë të printuara dhe fëmija, duke krahasuar, gjen produktin që duhet për të blerë.
- Në supermarket, fëmija me aftësi të kufizuar mund të zgjedhë produktet apo të mbushë karrocën me produktet e blera, mund të shtyjë karrocën, mund të paguajë lekët në arkë etj.

Aktivitetet realizohet në supermarket.

Unë jam kuzhinier

Materialet: produktet e një ushqimi që fëmija pëlqen më shumë dhe që do të paraqesë në panairin e ushqimit në shkollë, përparëse, doreza, enë gatimi

Veprimtaria:

- Në fillim, prindi i komunikon fëmijës qëllimin e kësaj veprimtarie. Së bashku me fëmijën, fillojnë të përmendin emrat e sendeve dhe produkteve që janë vendosur në tavolinë.
- Hap pas hapi, së bashku fillojnë të përgatisin dhe të gatujnë ushqimin që kanë zgjedhur për të bërë. Gjatë kësaj kohe, në bazë të mundësive dhe aftësive që mund të ketë fëmija, e angazhon atë në përgatitjen e recetës së përzgjedhur. Prindi duhet të ndihmojë dhe të udhëzojë fëmijën.
- Çdo veprim, prindi e koordinon me komunikim duke i kushtuar vëmendje dhe duke e parë fëmijën në sy. Gjatë përgatitjes së ushqimit, prindi përsërit shpeshherë emrat e produkteve që po përdorin, ushqimin që po përgatisin.



Aktivitetet realizohet në shtëpi.

Këndojmë dhe kërcëjmë këngët tona

Materialet: një magnetofon ose telefon ku të mund të vendosen këngë të zonës

Veprimtaria:

- Muzika është një terapi shumë e mirë për fëmijët me aftësi të kufizuar. Sugjerohet që në këtë aktivitet të marrë pjesë e gjithë familja.
- Avash-avash, nën tingujt e muzikës, fillohet të kërcëhen hapat e para të këngës.
- Sugjerohet që fëmija të futet në mes të të rriturve dhe të ketë mundësi të mësojë hapat me ta. Bashkimi dhe besimi të japin një ndjenjë të mirë.
- Ky aktivitet mund të zhvillohet edhe në shkollë në orën e muzikës apo atje ku mund të gjejë vend në kurrikul.



Aktivitet i koordinuar. Aktiviteti mund të realizohet në shtëpi por edhe në klasë

Panairi i traditës tonë

Materialet: Ushqime të përgatitura më parë në shtëpi nga prindërit dhe fëmijët, fëmijë dhe prindër të veshur me veshje tradicionale, tavolina për ekspozimin e ushqimeve, DJ me muzikë.

Veprimtaria:

- Sugjerohet që ky aktivitetet të udhëhiqet nga prindërit në koordinim me mësuesit.
- Sipas klasave, secili nga prindërit bashkë me fëmijët, janë udhëzuar për këndin ku do të vendosen ushqimet.
- Ata, në bashkëpunim me fëmijën e tyre me aftësi të kufizuar, vendosin ushqimet në vendin e caktuar dhe i prezantojnë ato në momentin e prezantimit.
- Vetë mësuesja ndihmëse, në bashkëpunim me prindin, vendosin edhe përgjegjësinë që do të ketë fëmija me aftësi të kufizuar në këtë prezantim.



- Pas prezantimit të ushqimeve, zhvillohet dhe pjesa e kërcimit me muzikë tradicionale. Këtu sugjerohet që të nxitet fëmija me aftësi të kufizuar të kërcëjë me bashkëmoshatarët.

Aktivitetet realizohet në shkollë ose në një ambient me hapësirë.

PJESA E DYTË

VEPRIMTARI MËSIMORE

Veprimtaritë e mëposhtme janë veprimtari të planifikuara dhe realizuara nga mësues ndihmës në sistemin arsimor parauniversitar. Ata janë shkëputur nga planifikimi i përditshëm që ata bëjnë për mbështetjen e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme të arsimit parauniversitar. Ajo që i dallon këto veprimtari është fokusi që i japin përfshirjes dhe angazhimit të prindërve dhe familjarëve të fëmijës në procesin e zhvillimit dhe edukimit të tij.

Përzgjedhja e tyre është bërë nga tërësia e veprimtarive që drejtuesit të rrjeteve profesionale kanë paraqitur pranë ASCAP, gjatë periudhës janar-mars 2021, në kuadër të nxitjes së përfshirjes së prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në edukimin e tyre. Në këtë kuadër janë përgatitur një sërë veprimtarish dhe seancash për zhvillim profesional nga drejtuesit dhe anëtarët e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.

Lënda: Gjuhë shqipe¹

Tema: Lojë shkathtësie me Kahoot.

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi në këtë orë mësimore:

- Dëgjon me vëmendje pyetjet.
- Përpunon informacionin për të dhënë përgjigjen e duhur.
- Dallon alternativën e saktë.

Materialet burimore: kompjuteri, video projektor, tablet.

Metodologjia: Bashkëbisedim, Lojë shkathtësie, Bisedë e lirë.

Hapi i parë: Bisedë me nxënësit dhe prindërit mbi mënyrën se si duhet të veprojnë mbi zgjidhjen e pyetjeve të zhvilluara me Kahoot për secilin nxënës në bazë të objektivave të vendosura në planin edukativ individual. Secili prind është ulur pranë fëmijës së tij me tabletin në dorë dhe duhet që ti lexojë pyetjen për ta ndihmuar atë në leximin e saktë të pyetjes dhe alternativave pasi ata kanë vështirësi në lexim.



Hapi i dytë: Kahoot përmban 7 pyetje për nxënësit. Bashkëpunimi i prindërit në këtë rast duhet që të ndihmojë fëmijën vetëm për të lexuar kërkesën dhe më pas nxënësi klikon mbi alternativën që atij i duket e saktë. Fëmijët nëpërmjet lojës japin përgjigjet e duhura me ndihmën e prindërve të tyre. Prindërit nuk duhet që të klikojë alternativën pasi nuk mund të matim dot njohuritë që fëmija ka përvetësuar.

¹ Përgatitur nga Gentjana Nito, mësuese ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Durrës

Hapi i tretë: Në këtë hap fëmijët njihen me rezultatin se kush fëmijë arriti që të zgjedhë pyetjet saktë dhe me shpejt duke i bërë një renditje. Ata japin mendimet e tyre se si u ndjenë gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie në grup.

Vlerësimi:

(organizimi, cilësia e detyrës, përqendrimi, lëvizshmëria, ruajtja e informacionit, etj.)

Gjatë kësaj veprimtarie nxënësit ishin të qetë dhe ndiheshin shumë të kënaqur pasi kishin prindërit e tyre pranë dhe arritën që të zgjedhin me sukses pyetjet e zhvilluara me Kahoot. Ata shprehën dëshirën që të punonin shpesh këtë veprimtari. Nxënësit ruanin mirë informacionin e marrë më parë. Përqendrimi ishte i mirë pasi ishin të fokusuar te situata që po ndodhte.



LËNDA: Matematikë²

KLASA: 8

Tematika: Figurat gjeometrike

Situatë e të nxënit: Mbajtja e maskës domosdoshmëri në ambientet e shkollës dhe jashtë saj.

Kjo orë mësimore realizohet me pjesëmarrjen e tre prindërve (nëna e nxënësit me AK dhe 2 nëna të nxënësve të klasës që ju përgjigjën ftesës sonë).

Rezultatet e të nxënit: Në fund të veprimtarisë nxënësi:

- ndërton drejtkëndësh në fletë .
- dallon duke emërtuar drejtkëndëshin mes figurave të tjera gjeometrike
- identifikon brinjët e tij dy e nga dy të barabarta.
- demonstroi aftësinë e tij në përgatitjen e maskës.

Mjetet: Fletë formati, vizore, laps, ngjyra, llastik, gërshërë, copa, gjilpërë, pe.

Lidhja me fushat e tjera dhe tema ndërkurikulare

Qytetari, Gjuha dhe komunikimi, Arte


Metoda: Diskutim, praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur, punë individuale

Organizimi i orës

Hapi i parë: Mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme për nxënësin duke i treguar fletën me

figurat gjeometrike:

- Emërto figurat gjeometrike.
- Shkruaj poshtë figurës emërtimet.



² Përgatitur nga Brunulda Zyka, mësuese ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Kamëz

- Zgjidh ngjyrën e preferuar dhe ngjyros drejtkëndëshin.

Hapi i dytë: Me vizore matim brinjët e tij dhe mbajmë shënime

Brinja 1 -22 cm

Brinja 2-15 cm

Brinja 3- 22 cm

Brinja 4- 15 cm

Kërkoj nga nxënësi të kuptojë që brinjët janë dy e nga dy të barabarta në drejtkëndësh.

Nxënësi i evidenton duke i shënuar me laps me ngjyra të ndryshme dy brinjë me të kuqe dhe dy me jeshile.

I gjithi ky proces bëhet me mbështetjen e prindërve të ftuar dhe që kanë pranuar të bëhen pjesë e veprimtarisë.

Hapi i tretë: Kthejmë fletën e formatit nga mbrapa dhe vazhdojmë veprimtarinë.

Në çdo brinjë matim me vizore në çdo skaj 5,5 cm (majtas-djathtas) dhe shënojmë me pikë.

Bashkojmë pikat me vizore duke krijuar një segment 22 cm.

Krijohen tre drejtkëndësha.

Palosim me nga 1 cm më poshtë secilën prej drejtkëndëshave të formuar

Kthejmë fletën e formatit dhe shikojmë formën e krijimit të një maskeje.

Hapi katërt: Pasi gjejmë formatin që i përngjan maskës, kërkoj nga nxënësi të tregoj rregullat që zbatohet në kohën e pandemisë si; larja e duarve, vendosja e maskës, vendosja e bërrylit kur kollitemi, etj.si mënyra me e mirë për tu ruajtur nga corona virusi.



Hapi pestë: Krijimin në fletë format e vizatojmë në copat dhe më pas e presim me gërshërë. Bashkojmë me gjilpërë copat dhe lastikun e krijojmë maskën.

Kjo veprimtari realizohet me ndihmën e 3 nënave që morën pjesë në këtë orë mësimore për prerjen me gërshërë të copës si dhe në përdorimin e gjilpërës. Në klasë është nëna e nx me Aftësi Ndryshe dhe dy nëna të nxënësve të tjerë. Prindërit janë të mirëpritura në klasë nga nxënësit dhe ndihmojnë duke udhëzuar nxënësit.

Lënda: Art pamor³

Kohëzgjatja: 45 minuta

Tema e mësimit: Aplikacin (Luledele)

Klasa: II-të

Teknikat e mësimit: Bashkëbisedim, demonstrim, punë e pavarur.

Konceptet e mësimit: Në fund të orës së mësimit nxënësi të jetë i aftë :

- të njohë Luledelen
- të presë me gërshërë format e gjethes
- të përdorë kapjen pincet (fine)

Mjetet e punës: fletë formati , laps , kolor , oriz , makarona të vogla , makarona të gjata , ngjytës lëng , fletë me ngjyrë jeshile , gërshërë.

Planifikimi i veprimtarisë

Hyrje: Ulem së bashku me nxënësin në bankë. E informoj për temën e mësimit. E pyes nëse ka parë në pranverë Luledele. Nëse ka bërë kurorë me lulen me mamin.

Faza e veprimtarisë:

Hapi 1: I shpjegoj nxënësit se sot do të krijojmë Luledelen. I tregoj materialet që do të përdorim dhe i vendos mbi bankë. Në fletën e formatit unë vizatoj Luledelen me laps, zemrën (pistilin) petalet, kërcellin dhe dy gjethë. Pasi mbaroj vizatimin i them se kjo është Luledelja dhe së bashku do plotësojmë me materialet që kemi dhe ngjyrat e duhura (zemra e verdhë me makaronat e vogla, petalet e bardha do t'i mbushim me oriz, kërcellin me një fije makarone të gjatë dhe gjethet do presim fletën me ngjyrë jeshile).

³ Përgatitur nga Elvira Taraj, mësues ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Selenicë

Hapi 2: Fillojmë me kërcellin: I them të marri një fije makarone të gjatë dhe ta ngjyros me kolor ngjyrë jeshile. Pasi e ngjyros i them se duhet ta lyejë me ngjitës dhe ta vendos te kërcelli i lules që kam vizatuar në fletë. Së bashku tek fleta me ngjyrë jeshile presim dy forma në formë gjetheje, i kërkoj t'i lyejë me ngjitës dhe t'i ngjisë afër kërcellit , kështu formuam kërcellin me gjethe.



Hapi 3: Tani i them se do të plotësojmë zemrën e Luledeles (pistilin).I them të marri makaronat e vogla dhe t'i lyej me ngjitës. Më pas i kërkoj t'i vendos brenda zemrës së lules deri sa të mbushet e gjithë zemra. Tani i them se do të mbushim petalet e Luledeles me oriz. I kërkoj të marrë oriz dhe ta lyej me ngjitës dhe më pas ta vendosë tek një nga petalet e vizatuara deri sa të mbushet gjithë petalja.

Hapi 4: gjatë fundit të veprimtarisë, krijoj mundësinë që të na afrohet gjatë punës dhe prindi. I shpjegoj prindit se si kemi punuar dhe e udhëzoj që ta vazhdojë punën me tej në shtëpi deri a në orën e ardhshme ta kemi produktin final gati.

Sinteza: Si aktivitet vendosëm të aplikacion Luledele. Përdorëm fletë formati, makarona, oriz, ngjitës, kolor, fletë me ngjyrë, laps. Duke i shpjeguar nxënësit etapat e veprimtarisë, filluam ndërtimin e Luledeles dhe pjesën e mbushjes së petaleve për efekt kohe nxënësi do ta përfundoj në shtëpi me ndihmën e prindit.



Lënda: Gjuhë shqipe⁴

Shkolla: “Demokracia”

Klasa: II-b

Tema: Emrat e qyteteve të vendit tonë

Me qëllim orientimin e veprimtarive mësimore drejt të mësuarit me kompetenca, në klasën e dytë u zhvillua një orë mësimi ndryshe nga të tjerat.

E ftuar në klasë ishte një prind nga klasa, mësuesja e gjeografisë, e cila me shpjegimin e saj aq të bukur, iu shtoi nxënësve të vegjël dëshirën për të njohur gjeografinë e vendit tonë dhe për të mos harruar emrat e përveçëm që e përfaqësojnë atë.

Rezultate e të nxënit:

Nxënësit në përgjithësi:

- Identifikojnë në hartë qytetet e vendit tonë
- Flasin për qytetet që kanë vizituar
- Plotësojnë hartën skicë
- Bashkëpunojnë me njëri tjetrin

Nxënësja me aftësi të kufizuara:

- Bashkëpunon me nxënësit e tjerë
- Përqendrohet tek qendrat e aktivitetit
- Merr disa komanda
- Plotëson detyrën me ndihmë

Ora mësimore organizohet sipas planifikimit të bërë nga mësuesja e klasës në bashkëpunim me mësuesin ndihmës dhe prindin. Mbështetja e mësueses ndihmëse konsiston në orientimin e nxënësës për tu përqendruar në qendrat e aktivitetit dhe të marrë komandat.

⁴ Përgatitur nga Rajmonda Mollaymeri, mësues ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Selenicë

Ka momente kur mësuesja e lëndës ndihmon nxënësen dhe mësuesja ndihmëse ndjek dhe orienton punën e nxënësve të tjerë në klasë.

Përmes kësaj mbështetjeje krijohet një klimë pozitive në klasë duke me plotësimin e detyrës në fletën e punës së përgatitur, duke shqiptuar në grup dhe në kor disa emra qytetesh dhe duke e shndërruar si një lojë apo garë shqiptimin e tyre.

Materiale që u përdorën:

- Fletë formati
- Lapustila
- Hartë
- Dërrasa e zezë

Lënda: Art pamor⁵


Klasa: 4-t

Objektivi lëndor: Të identifikojë katër ngjyrat bazë (e kuqe, blu, e verdhe, e gjelbër).

Objektivi i aktivitetit: Të klasifikojë objektet sipas së njëjtës ngjyrë, me ndihmë vizuale të mësueses (mësuesja vendos gishtin tek objekti në të njëjtën kohë që thotë emrin e ngjyrës)

Aktivitetet e zhvilluara:

- Nxënësi pozicionohet në vendin e vet.
- I komunikohet që do të punojmë me ngjyrat.
- I tregohen nxënësit disa petëza, lapsa, shufra, rruaza me ngjyra të ndryshme, duke i demonstruar objektet një e nga një dhe duke emërtuar ngjyrat.
- Mësuesja vendos çifte të ndryshme nga objektet e sipërpërmendura të së njëjtës ngjyrë dhe përsëri përcakton ngjyrën e tyre.
- I kërkohet nxënësit të përsëritë aktivitetin që realizojë mësuesja pak me parë, dhe mësuesja citon emrin e ngjyrës (nxënësi nuk ka komunikim verbal).
- Më pas i kërkohet të klasifikojë objekte të së njëjtës ngjyre.
- Aktivitetet përsëriten disa herë.



Bashkëpunimi: Nxënësi ndiqte udhëzimet e mësueses, reagonte ndaj kërkesës që i bëhej. Bashkëpunimi ishte në nivele të kënaqshme.

Vështirësitë: Vijueshmëria e aktivitetit pa e ndërprerë. Shkëputja e shpeshtë e përqendrimit. Vështirësi në dallimin e ngjyrës së gjelbër me blu.


⁵ Përgatitur nga Rovena Elezi, mësuese ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Tiranë

Reagimet sjellore dhe emocionale: Në momentin që nxënësi më AK shpërqendrohet nga aktiviteti që po kryen nxjerr vokalicë të larta, qesh me zë të lartë dhe kur është duke punuar, lëshon objektin që ka në dorë dhe ngrihet nga karrigia.

Rezultati: Nxënësi arriti që në fund të aktivitetit të klasifikonte objektet sipas katër ngjyrave të përmendura në objektiv, duke u ndihmuar më së shumti për dallimin e ngjyrave e gjelbër dhe blu.

Sugjerime (detyrë): Prindit iu dërguan nëpërmjet rrjetit të Whatsapp –it foto nga aktivitetet e bëra në klasë. Nga mësuesja u këshillua të realizojë aktivitete të ndryshme me objekte që mund ti gjejë në përdorim të përditshëm në familje.

Mësuesja duhet të vazhdojë të punojë me nxënësin punën për të përvetësuar me mire ngjyrat e gjelbër dhe blu që nxënësi i ngatërronte në identifikim kur dëgjonte emërtimin. Do punohet gjithashtu dhe në lëndën e gjuhës shqipe për të identifikuar ngjyrën dhe emërtimin e tyre të shkruar.



Lënda: Abetare ⁶

Klasa: I-rë

Tema: Shkronja e dorës K.k

Situata e të nxënit: Kukulla.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:

- Dallon shkronjën K.k në fjalë.
- Shqipton saktë tingullin K.
- Lexon rrokjet e formuara me shkronjën K duke shqiptuar saktë ato.
- Bashkëpunon gjatë orës mësimore.
- Lidh shkronjën e shtypit k me shkronjën e dorës K.
- Shkruan shkronjën e dorës K sipas modelit.
- Bashkëpunon duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga mësuesja.

Fjalë kyç: kukull, këndes, kalë, zanore, rrokje.

Burimet: Abetare, fletë pune abetare, etiketa me shkronjën K.k fletore, mjete shkrimi.

Organizimi i orës mësimore

Puna do të alternohet në bashkëpunim me prindin dhe mësuesen e klasës dhe mësuesen ndihmëse

Hapi 1: Mësuesja i fton nxënësit të shohin në tabelë modelin e shkronjës K të dorës. Në bashkëpunim me prindin nxënësi ndjek mësuesen. I vendos në bankë nxënësit etiketën me shkronjën K të shtypit duke bërë lidhjen midis shkronjës së shtypit dhe shkronjës së dorës K. Mësuesja e modelon në tabelë dhe



⁶ Përgatitur nga Alketa Kolojari, mësuese ndihmëse dhe drejtuese e ZVAP Tiranë

gjithashtu e shpjegon sipas etapave. Nxënësi e ndjek me vëmendje.

Hapi 2: Veprimtari e drejtuar. Mësuesja i fton nxënësit të shohin në tabelë modelin e shkronjës k të vogël të dorës. Ajo e modelon në tabelë dhe gjithashtu e shpjegon sipas etapave. Ngre nxënësin në tabelë dhe e ndihmoj të shkruajë shkronjën K të madhe të dorës dhe k të vogël të dorës

Hapi 3: Punë individuale dhe e mbikëqyrur. Nxënësi shkruan individualisht modelin e shkronjës K të dorës në fletore por i mbikëqyrur nga prindi.

Hapi 4: Mësuesja fton nxënësit të hapin librin në faqen 62 të fletores së punës ku janë modeluar shkronjat “K”, “k” të dorës dhe u kërkon të fillojnë shkrimin e tyre duke i ndarë nga njëra – tjetra me një gisht. Gjatë punës e ndjek ecurinë e nxënësit duke e inkurajuar.



Pasi nxënësi i ka ndjekur të gjitha udhëzimet dhe ai ka qenë bashkëpunues do të marrë si shpërblim një yll, flamur dhe një buzëqeshje në dorën e tij.

Detyrë: Shkruaj ne fletore me shkronja dore fjalët e dhëna.

Vlerësimi: Vlerësoj bashkëpunimin e nxënësit gjatë punës në klasë. vlerësoj shkrimin e shkronjës “K” te madhe të dorës dhe “k” të vogël të dorës.

Rezultati: Punoi i qetë dhe bashkëpunues. Ndoqi të gjitha hapat sipas komandave të dhëna. Shkroi në mënyrë të pavarur duke kopjuar modelin e dhënë.

Lënda: Biologji⁷

Tema e mësimit: Pjesët përbërëse të një bime.

Rezultatet e të nxënit sipas temës:

- Liston disa bimë që ka në shtëpi
- Bashkon pjesët e pazellit duke formuar bimën.
- Identifikon pjesët përbërëse të bimës duke e parë konkretisht

Fjalët kyçe: Bimë, kërcell, gjethe, trung, kurorë, rrënjë


Mjetet mësimore: Pazëll, fleta A4, lapustila, bimë natyrale.

Përshkrimi i veprimtarisë mësimore:

Hapi i parë: Bëj takimin e mëngjesit me nxënësin ku interesohem dhe informohem mbi gjendjen e tij psiko-emocionale dhe shëndetësore

Hapi i dytë: Kontrollon detyrat e shtëpisë, diskutojmë shkurtimisht rreth tyre dhe e motivoj me anë të vlerësimit

Hapi i tretë: Njihet nxënësi me temën e re mësimore me anë të materialeve dhe mjeteve që janë vendosur mbi bankë (bimë natyrale, pazëll dhe foto të ndryshme) ku nxënësi përshkruan fotot me bimë të ndryshme dhe së bashku formojmë pazëllin me pjesët e bimës. I kërkohet nxënësit të emërtojë 2-3 bimë që ai ka në oborrin e tij p.sh. hurma, shega, lule të ndryshme etj.



Hapi i katërt: Me anë të një bime natyrale që nxënësi ka mbi tavolinë emërtojmë në mënyrë konkrete pjesët përbërëse të saj: rrënjë, kërcelli, gjethe, lule. Në pjesën e fundit nxënësi kopjon në fletoren e klasës pjesët përbërëse të lules.

⁷ Përgatitur nga Albana Myzyri, mësuese ndihmëse dhe drejtuese e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës në ZVAP Elbasan



Refleksione: Nxënësi ishte pozitiv dhe bashkëpunues gjatë orës mësimore duke përmbushur në mënyrë të kënaqshme objektivat.

Detyra të realizuara në bashkëpunim me familjen: Me ndihmën e prindit nxënësi arrin që të kujdeset për lulet në shtëpinë e tij dhe vizaton dhe ngjyros një lule me sipas stilit të tij.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



sekretaria@ascap.edu.l



www.ascap.edu.al



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit
Parauniversitar



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit
Parauniversitar